

HAXHI ADEMI

POZITA E SHQIPTARËVE NË FRONTIN E ADRIATIKUT DHE MASAKRA E TIVARIT

Abstrakt

Në këtë artikull trajtohet pozita e shqiptarëve në Frontin e Adriatikut dhe në veçanti Masakra e Tivarit. Gjatë tërheqjes së ushtrisë gjermane nga territori i ish-Jugosllavisë, u krijuan dy fronte: fronti i Sremit të Vojvodinës dhe fronti i Adriatikut në veriperëndim të Jugosllavisë. Shqiptarët u rekrutuan për t'u dërguar në luftime në këto fronte ndërsa brigadat serbe i forcuan pozitat e tyre në territorin e Kosovës. Gjithsej për plotësimin e reparteve jugosllave nga Kosova dhe viset e tjera etnike u rekrutuan dhe u dërguan në luftime larg Kosovës 37 424 shqiptarë. Por, krahas largimit nga Kosova të Brigadave kosovare në Kosovë u vendosen 40 mijë ushtarë dhe oficer elitë të cilët kishin për detyrë ta ndihmonin vendosjen e "pushtetit popullor".

Gjatë muajit mars dhe prill të vitit 1945, rreth 13.000 rekrutë shqiptarë u dëbuan me forcë nga Kosova dhe rreth 5000 nga Maqedonia. Këta rekrutë u dërguan të paarmatosur në Frontin e Adriatikut. Pikë mbledhja e këtyre rekrutëve u caktua Prizreni, por është me rëndësi të përmendet fakti që gjithë rekrutët shqiptarë u çarmatosën me arsyetimin se do të lodheshin nga rruga dhe se kur të mbërrinin në front do të pajiseshin me armë moderne angleze. Ky ishte mashtrimi i parë që iu bë shqiptarëve, të cilët, të mobilizuar përshkuan rrugën Prizren–Kukës–Shkodër–Tivar–Dubrovnik–Rijekë. Përgjatë kësaj rruge mijëra shqiptarë gjetën vdekjen, që sipas të mbijetuarve numri i të vdekurve apo të vrarëve gjatë rrugëtimit nga Prizreni deri në Tivar dhe në Masakrën e Tivarit ishte me mijëra. Shqiptarët, u vranë nga bashkëluftëtarët e tyre partizanë jugosllavë, por, në vrasjen e tyre kanë marrë pjesë dhe popullsia vendase malazeze si dhe popullsia civile serbo-malazeze të cilët ishin vendosur si kolonë në vitet 20-30-të në Kosovë, ndërsa ishin larguar nga Kosova pas luftës së prillit 1941.

Së fundmi, mund të themi se masakra e mijëra shqiptarëve të pafajshëm në territoret shqiptare dhe ato jugosllave në vitin 1945, mund të jetë një ndër krimet më të mëdha ndaj bashkëluftëtarëve për të luftuar armikun e përbashkët gjerman.

Trajtimi i pozitës së shqiptarëve në Jugosllavi në fund të Luftës së Dytë Botërore dhe Masakra e Tivarit

Ndonëse çështja e pozitës së shqiptarëve në Jugosllavi në fund të Luftës së Dytë Botërore dhe në veçanti Masakra e Tivarit deri më sot, për arsye nga më të ndryshmet, nuk është trajtuar sa duhet e si duhet, andaj vendosa të trajtoj në mënyrë objektive këtë çështje tejet të rëndësishme për historinë e shqiptarëve. Kjo çështje duhet të trajtohet për së paku dy arsye: së pari, për shkak se studimet e deritanishme për këtë problematikë nuk kanë nxjerrë rezultate të kënaqshme shkencore, por në të shumtën e rasteve janë të dhëna fragmentare dhe së dyti, për të zbardhur të vërtetën e Masakrës së Tivarit, këtij misteri të historisë kombëtare shqiptare.

Pas largimit të trupave gjermane nga Kosova dhe në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, popullsia shqiptare u përball me presion të vazhdueshëm nga udhëheqësit komunistë serbo-jugosllav, të cilët përdorën dhunën dhe represionin ndaj shqiptarëve. Për më tepër, serbët iu rikthyen elaborateve të tyre, të hartuara më parë nga Vasa Çubriloviqi, me titull “Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re”. Sipas këtij elaborati, që u ridizajnuua dhe u paraqit më 3 nëntor 1944, parashihej mënyra se si duhet zgjidhur çështja e “pakicave” në Vojvodinë dhe në Serbinë e Vjetër-Kosovë “...zgjedhja e vetme dhe e drejtë e kësaj çështje është shpërngulja e këtyre...shpërngulja është më lehtë të zgjidhet gjatë kohës së luftës siç është kjo... asnjëherë nuk kemi pas kushte me të favorshme ... sesa në këtë moment”.¹ Kjo platformë e spastrimit etnik të Kosovës dhe më gjerë parashikonte në thelb po atë qëndrim të Drazha Mihajloviçit, të vitit 1941.* Platforma e tij gjeti mbështetje tek udhëheqja jugosllave, andaj në dimrin e vitit 1944 dhe fillimin e vitit 1945 njësitë e “nacionalçlirimtares” serbo-malazeze, bën çarmatimin e popullsisë shqiptare të Kosovës. Ndërsa me parullën “të gjithë në front – gjithëcka për front”, bënë rekrutimin e shqiptarëve me dhunë për dërgimin në njësitë e Armatës

¹ Vaso Çubrilloviq, *Shpërngulja e shqiptarëve*, SHBA: Botuar nga Zëri i Kosovës, Organ i Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, 1992, f. 9-17; Marenglen Verli, *Kosova në fokusin e historisë*, Tiranë: Botimpex, 2003, f. 66.

* Shtabi Komandues i radhëve çetnike të Ushtrisë Jugosllave i kryesuar nga Drazha Mihajloviçi, më 20 dhjetor të vitit 1941 hartoi platformën e programit të saj që shpallte: “Krijimin e Jugosllavisë së madhe dhe në të, të Serbisë së madhe, etnikisht të pastër në kufijtë e Serbisë e të Malit Zi, të Bosnje e Hercegovinës, të Sremit, Banatit e Baçkës. Spastrimi i territorit shtetëror nga të gjitha pakicat kombëtare dhe elementet jo nacionale”. *Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës* (më tej: *ASHAK*), Fondi (më tej: F.) Komiteti Krahinor i LK të Kosovës, Viti (më tej: V) 1941, kutia 5, dokumenti nr. 2031, f. 1-3. Platformë e Programit të Shtabit Komandues të radhëve çetnike të Ushtrisë Jugosllave, dhjetor 1941.

Jugosllave. Deklaratat e tyre premtuese për vetëvendosjen e popullit shqiptar pas luftës u harruan.² Me qëllim të spastrimit etnik të Kosovës dhe të viseve shqiptare përreth saj,³ Shtabi Suprem i Armatës Jugosllave (SHSAJ) kishte dhënë urdhër për mobilizimin e 30 deri 50 mijë shqiptarëve* për nevojat e Armatës Jugosllave (AJ) në Jugosllavi.⁴ Por, krahas largimit nga Kosova të brigadave kosovare, në Kosovë do të vendosën 40 mijë ushtarë dhe oficerë elitë, të cilët kishin për detyrë ta ndihmonin vendosjen e “pushtetit popullor”-okupimin jugosllav të Kosovës”.⁵

Kështu, më 8 shkurt 1945, në territorin e Kosovës vendoset Administrata Ushtarake** me këtë rast bëhen edhe ndërrimet në kuadër të udhëheqjes në Shtabin Operativ të Kosovës.⁶ Pushteti Ushtarak hiqet në qershor të viti 1945.⁷ Për më tepër, në emër të këtij pushteti, Kosova u mbush me forca ushtarake,***

² Hakif Bajrami, *Tragjedia e Tivarit*, (Çka i parapriu tragjedisë, qëllimet dhe pasojat), Prishtinë: 1993, f. 176.

³ Muhamet Pirraku, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1992, f. 121-135; Muhamet Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës*, Prishtinë: Lidhja e Historianëve e Kosovës “Ali Hadri”, 2005, f. 29.

* Nga Kosova do të largohen shumica e brigadave kosovare, rreth 15 260 sa kishte Brigada VII e Kosovës, vetëm më 19-23 janar 1945 në drejtim të Vojvodinës u dërguan rreth 19 mijë rekrutë të mobilizuar. Shih në M. Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës...*, f. 29.

⁴ M. Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës...*, f. 29.

⁵ Hakif Bajrami, “Dokumenti NOB-a i Socijalisticka Revolucije – Borbe na Kosova (mart-maj 1945)”, *Vjetari*, XXIII, Prishtinë: Arkivi i Kosovës 1987, f. 203-367; M. Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës...*, f. 31.

** Për vendosjen e Administrimit Ushtarak në Kosovë, Komandanti Suprem i Forcave të Armatosura të Jugosllavisë J. B. Tito, kishte ftuar në Beograd, më 7 shkurt 1945 njerëzit të cilët kishte besim për veprime të caktuara, ata të cilët do të udhëhiqnin Administrimin Ushtarak në Kosovë si Savo Drleviqin, Gjuro Medenicën dhe Kristo Filipoviqin, të cilët u deleguan nga KQ i PKJ-së, me qëllim të vendosjes së pushtetit “popullor”. Në realitet u vendos pushteti ushtarak dhe jo ai popullor, ngase e gjithë struktura komanduese përbëhej prej serbo-malazezëve, të cilët ushtronin pushtetin ushtarak, që mori kompetencat, ekzekutive dhe gjyqësore. Shih në Hakif Bajrami, “Pasoja e diktaturës ushtarake për shqiptarët”, Prishtinë: Gazeta *Epoka e Re*, 22.10.2015, f. 11.

⁶ Daut Bislimi, *Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1997, f. 215.

⁷ Veton Surroi, *Fadil Hoxha në veten e parë*, Botimi i dytë, Prishtinë: Koha, 2010, f. 265.

*** Në Kosovë u vendosën këto forca ushtarake: Divizioni, 21, 24 dhe 46 serb, Divizioni, 52 i Kosovës, Grupi i brigadave: 1, 3, 4, 5 të Kosovës; Brigada e Bokelit dhe Brigada e Malit të Zi, me çka Kosova duhej t’i kishte tri divizione me më se 30.000 ushtarë, me teknikën moderne ushtarake, Divizioni i 50-të dhe i 51-të i

të cilat gjatë muajit shkurt në Mitrovicë kanë vrarë rreth dy mijë veta, ngase refuzonin të largoheshin nga Kosova, për të plotësuar njësitet e armatës jugosllave.⁸ Por, shqiptarët rezistuan ndaj pushtetit jugosllav. Kështu, betejat ndërmjet forcave ushtarake jugosllave dhe luftëtarëve të Lëvizjes Kombëtare, në krye Shaban Palluzhën u zhvilluan më 18-19 shkurt 1945, kryesisht në territorin e Shalës dhe të Drenicës. Në luftimet e ashpra të 21 shkurtit 1945, është vrarë prijësi i tyre, Shaban Palluzha⁹ dhe njëkohësisht u shpërbë grupi i tij.¹⁰ Pas, këtij sulmi dhe vrasjes së Shaban Palluzhës, grupi i Drenicës u shpartallua, por megjithatë rezistenca e popullit shqiptar vazhdoi edhe më tej.

Por, pa marrë parasysh rezistencën e popullit shqiptar ndaj pushtetit të Beogradit, Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Maqedoni dhe në Mal të Zi mbetën sërish në kuadër të Jugosllavisë, duke iu mohuar e drejta për bashkim me shtetin shqiptar, dëshirë që e proklamuan në Rezolutën e Konferencës së Bujanit (1943/44). Por, është me rëndësi të përmendim mendimin e njërit nga këshilltarët më të ngushtë të Titos, Eduart Kardel, i cili nga fundi i shkurtit 1945 kishte shtruar një mendim që mund ta përmbledhim me këtë fjali: “Zgjidhja më e mirë do të ishte që Kosova të bashkohet me Shqipërinë, por meqë as faktori i huaj, as faktori i brendshëm, nuk e përkrahin këtë, ajo duhet të mbetet një provincë kompakte në kuadër të Serbisë”.¹¹ Pra, qëndrimi zyrtar i qeverisë jugosllave ishte armiqësor dhe aspak demokratik. Kështu, Beogradi zyrtar ka ndjekur një politikë shoviniste kundrejt popullsisë shqiptare në ish Jugosllavi “Mbas çlirimit të këtyre krahinave nga okupatori fashist trupat

Maqedonisë, Divizioni i 5-të dhe i 6-të shqiptarë, Korpusi i MP-së i Kosovës dhe shumë njësi të tjera ushtarake me karakter lokal. Nga data 10-12 shkurt, u vranë më se 260 shqiptarë, 12 u pushkatuan, 99 u zunë robër ndërsa 68 iu dorëzuan organeve të pushtetit më gjerësisht. Shih në Azem Hajdin –Xani, *Shaban Palluzha*, Dëshmi dhe kujtime të kronistit të luftë, I, Prishtinë: Rilindja, 2001, f. 288-289; D. Bislimi, *Formacionet politiko-ushtarake...*, f. 169.

⁸ Robert Elsie, *Kosovo and the Bar Tragedy of Mach 1945*, Published in: Südost-Forschungen, Munich, 71, 2012, f. 5.

⁹ D. Bislimi, *Formacionet politiko-ushtarake...*, f. 169; Rober Elsi, *Fjalor Historik i Kosovës*, Skanderbeg Books, Tiranë, 2011, f. 252.

¹⁰ Lefter Nasi, “Aspekte nga veprimtaria e formacioneve të UNÇSH në Kosovës e në Jugosllavi (tetor 1944-mars 1945)”, *Studime Historike*, Nr.1, Tiranë, 1991, f. 49-63; Izber Hoti, *Në udhëkryqet e Historisë dhe të Historiografisë shqiptare*, Prishtinë: Instituti i Historisë- Prishtinë, 2003, f. 230-238; Sabit Syla, “Drenica në fund të Luftës së Dytë Botërore”, në *Studime për historinë ushtarake*, Tiranë: Instituti i Studimeve të Historisë Ushtarake, 2014, f. 71; Haxhi Ademi, “Interpretimi i literaturës historiografike shqiptare për ripushtimin jugosllav të Kosovës dhe Lufta e Drenicës”, në *Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1944-1945)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2016, f. 277-298.

¹¹ Noel Malcom, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë: Koha, 2011, f. 399.

*jugosllave që u vendosën pas largimit të brigadave partizane shqiptare shpërthyen terror të pa shembull kundrejt popullsisë vendase me pretekstin se gjithë kishin lidhje me okupatorin, duke vrarë dhe burgosur mijëra shqiptarë të pafajshëm si për shembull vrasjen e ushtarëve shqiptarë në Tivar dhe në fshatrat e Maqedonisë”.*¹²

Mobilizimi i shqiptarëve të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi drejtë frontit të Adriatikut

Komandanti i Shtabit Operativ të Kosovës (më tej: SHOK), Sava Drleviq, më 20 mars 1945, kërkonte nga shtabet e divizioneve jugosllave që ishin përqendruar në Kosovë: 41, 46, dhe 52, Grupi i brigadave (malazezo-kosovare) dhe të Komandës Ushtarake Krahinore të Kosmetit (Kosovës - H.A.) që artileria, kalorësia dhe inxhinieria nga radhët e të mobilizuarve t'i dërgoheshin SHO të Kosovës, kurse nga 800 “njerëz” t'u dërgoheshin “Grupit të brigadave” në Pejë dhe Shtabit të Divizionit 52 në Ferizaj, ndërsa “krejt pjesa tjetër e njerëzve të dërgohen në Prizren, ku do të formohen dy grupe, prej nga do të vazhdojnë tutje” në drejtim të Tivarit.¹³ Për mbikëqyrjen e këtyre rekrutëve u ngarkua Shtabi i Divizionit 46-të dhe Qarkkomanda ushtarake e Prizrenit.¹⁴ Kështu, brigadat partizane shqiptaro-kosovare marshonin drejt veriut dhe luftonin përkrah popujve të tjerë të Jugosllavisë për çlirimin e plotë të saj. Krahas brigadave marshuan edhe kontingjente të tëra të rinjve shqiptarë që u inkuadruan në formacione ushtarake nëpërmjet mobilizimit të përgjithshëm të dhunshëm gjatë muajve mars dhe prill 1945, për t'i dërguar në frontin e dytë të “Adriatikut”, në veriperëndim të ish-Jugosllavisë të gjithë meshkuj nga mosha 18 deri 45 vjeç.¹⁵ Mobilizimi në masë i djemve dhe burrave u bë nga të gjitha viset etnike shqiptare për nevojat e Armatës Jugosllave.¹⁶ Në Prizren të gjithë u çarmatosën me arsyetimin se do të lodheshin nga rruga e gjatë, por kur të mbërrinin në frontin e luftimeve, iu tha se do të pajiseshin me armë moderne angleze. Çarmatosja, iu ka dhënë atyre një sinjal të keq dhe me të drejtë ka lindur dyshimi për përgatitjen e ndonjë skenari shfarosës në prapaskenë. Kjo psikoze u thellua edhe më tepër, atëherë kur u çarmatosën edhe oficerët shqiptarë dhe për përcjelljen e tyre u ngarkua Brigada XXVII e divizionit 46-të serb e njohur për terrorizimin e popullit shqiptar. Skenaristët e

¹² *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë* (më tej: AMPJ), Fondi (më tej: F) 151, Dosja (më tej: D 514/1, Viti (më tej: V) 1959, f. 47. Problemi i Kosovës.

¹³ <https://archive.koha.net/?id=&l=51072>

¹⁴ M. Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës...*, f. 33

¹⁵ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 173.

¹⁶ Azem Hajdini, *Tragjedia e Tivarit* (Memoare), Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë, 1998, f. 17-34.

Masakrës së Tivarit, për dërgimin e 13 mijë mobilizuesve shqiptarë në pjesët veriperëndimore të Jugosllavisë, kishin zgjedhur rrugën Prizren–Kukës–Shkodër–Tivar–Dubrovnik–Rijekë.¹⁷ Depërtimi i shqiptarëve të mobilizuar në muajin mars, nga kazermat e Prizrenit u bë në tri grupime.¹⁸

Më poshtë, do të japim rrugëtimin e rekrutëve shqiptarë nga Kosova deri në Tivar të ndarë sipas grupimeve. Kështu, grupin e parë të të mobilizuarve do ta përbënin rreth (2200 luftëtarë) nga qarkkomanda e Ferizajt dhe (1500 luftëtar) nga qarkkomanda e Prizrenit*, që do të thotë rreth 3700 rekrutë shqiptarë. “Grupi” nga Ferizaj, më 21 mars 1945, duhet të përcillej nga një ose dy batalione të Divizionit të 52-të nën komandën e Radosh Gjudoviqit, qarkkomandant i Ferizajt. Ky grupim duhej të nisej nga Prizreni më 24 mars*, i përcjellë prej një batalioni të Divizionit 46-të dhe të 50-të “udhëheqësve nga

¹⁷ M. Pirraku, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës...*, f. 121-135; M. Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës...*, f. 29.

¹⁸ Zekeria Cana, *Ditari i Robërisë*, Vëllimi I, Prishtinë: Rozafa, 2000, f. 154-155.

* Bazuar në burimet e autorëve që kanë trajtuar këtë ngjarje, Shtabi i 46-të i Divizionit të Serbisë i rrethinës së Prizrenit ka vrarë në Opojë 23 shqiptarë dhe ka mobilizuar 240 të tjerë, por ka edhe nga ata që thonë se gjatë kësaj periudhe në Dragash janë vrarë 500 veta. Mirëpo, numri i banorëve nga Dragashi që u mobilizuan dhe u nisën për në Tivar sillej rreth 500 veta, sepse jo vetëm nga Opoja, por ishte edhe një numër i konsiderueshëm i banorëve nga Gora që morën pjesë në këtë ngjarje. Shih në Nuridin Ahmeti, “Masakra e Tivarit në kujtesën e disa opojanëve”, *Gazeta 55*, Nr.211 (4276), Tiranë, E martë 3 gusht, 2010; N. Ahmeti, “Masakra e Tivarit në kujtesën e disa opojanëve”, *Bota Sot*, nr.5425, 5426, 5427, Prishtinë, E merkur, e enjte, e premte, 4-6 gusht, 2010.

* Kolona/eshaloni i Parë u nis nga Prizreni për në Shkodër e më pas drejt frontit të Adriatikut më 24 mars 1945, në orën 7.00, siç ishte planifikuar nga Shtabi Operativ i Kosovës, në koordinim me Shtabin Kryesor të Serbisë dhe Shtabin Suprem të Jugosllavisë. Të gjithë rekrutët në këtë kolonë dhe në kolonat e tjera ishin shqiptarë të mobilizuar pa dëshirën e tyre. Qëllimi ishte që të zbrazej Kosova nga burrat dhe sidomos djemtë e rinj shqiptarë, të pakënaqur dhe të aftë t’i rezistonin pushtetit të ri komunist që do të vendosej. Torturat dhe masakrat ndaj rekrutëve shqiptarë filluan në afërsi të Suharekës e vazhduan në afërsi të Kukësit. Ushtarëve shqiptarë që protestonin ndaj trajtimit të keq iu lidheshin duart, vriteshin natën dhe kufomat e tyre hidheshin në greminë nga shkëmbinjtë e lartë. Vriteshin para syve të shokëve të tyre ata që ishin të sëmurë apo ata që nuk mundnin të ecnin në hap me të tjerët. Në Kukës i ushqyen me mish dhie të thatë me kripë (pastërma), me qëllim që t’u shkactohej etja. Të gjithë ata shqiptarë që tentonin ta shuanin etjen në ndonjë burim, përrockë apo lumë, pushkatoheshin. E gjithë kjo realizohej me lehtësi ngase shqiptarët ishin të paarmatosur. Më gjerësisht shih: Uran Butka, *Masakra e Tivarit dhe përgjegjësia e shtetit shqiptarë*, Tiranë: ASD-studio, 2011, f. 118-125; Fejzulla Gjabri, “Një dëshmi nga Masakra e Tivarit”, në *E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë etnike*, Prizren: Shoqata “Trojet e Arbërit”, 2011, nr.19, f. 317-320.

Armata e IV-të¹⁹, ndërsa më 27 mars duhej të arrinte në Shkodër, ku pas një pushimi ditor nisej për në Tivar^{**}. Grupin e dytë, e përbëjnë rreth 900 luftëtarë nga rrethi i Pejës, nën komandën e Janko Llaciçeviq, qarkkomandant i Pejës, rreth 1400 luftëtarë nga rrethi i Mitrovicës, të komanduar nga komandanti i Çarkut të Mitrovicës dhe rreth 1500 luftëtarë nga rrethi i Prishtinës, nën komandën e oficerit të qarkkomandës, që do të thotë në tërësi diku 3800^{***} luftëtarë.²⁰ Për të shoqëruar kolonën e dytë u ngarkuan repartet e Divizionit të 46-të Jugosllave.

Pas arritjes së të gjitha forcave në Prizren, Shtabi Operativ i Kosovës, bëri ndryshimet përkatëse. Ai ndau të mobilizuarit në tri grupe me rreth 2500 veta. Për shoqërimin e tyre ngarkohet Brigada e 27-të e Divizionit të 46-të.²¹

Komandanti i SHOK-ës, Sava Dërleviq u sugjeronte dhe i urdhëronte njësitet që do të ngarkoheshin për t'i transportuar njerëzit e mobilizuar që “...*gjatë transportit të kenë kujdes që njerëzve t’ua pamundësojnë dezertimin, kurse gjatë pushimit të bëhet bllokimi i kuarteve të banimit..*”. Komandantët dhe Komisarët politikë do të jenë personalisht përgjegjës, nëse nga pakujdesia ua mundësojnë ikjen.²² Nga Prizreni Kolona/grupi i parë me 2394* vetë u nis më 24 mars dhe në fund të muajit arriti në Tivar, ku iu dorëzua repartete të Divizionit të 9-të Jugosllav.²³ Për më tepër në burimet e kohës thuhej: “... *disa shqiptarë janë likuiduar pranë Suharekës ... disa burra u likuiduan pranë Kukësit, ku ishin trupat e tyre hedhur në një luginë ...*”²⁴ Gjatë rrugës janë vrarë rreth 400 shqiptarë, ndërsa sa i përket kushteve gjatë marshimit të detyruar ishin të tmerrshme.²⁵

Kolona/grupi i dytë, i përbërë nga 2382 vetë, u nis nga Prizreni më 26 mars.^{**} Rekrutët e grupit të dytë arritën në Shkodër më 30 mars, ndërsa kur

¹⁹ M. Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës...*, f. 33.

^{**} Të dhënat për largimin nga Shkodra që na i ofron i mbijetuari i kësaj masakre janë kontradiktore, ai thotë: Në Tivar arritëm më 29 mars f. 23, ndërsa në f. 35 thotë: Nga Shkodra u nisëm më 29 mars. Shih në A. Hajdini-Xani, *Masakra e Tivarit...*

^{***} Sipas A. Hajdini- Xani, në Eshalonin e Dytë ishin 4700 luftëtarë, *Masakra e Tivarit...*, f. 17.

²⁰ M. Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës...*, f. 33.

²¹ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 174.

²² M. Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës...*, f. 34.

* Nga Prizreni u nisën 3700 luftëtarë, ndërsa nga Shkodra u nisën 2394, që i bije se, rrugës nga Prizreni deri në Shkodër u likuiduan 1306 persona. Më gjerësisht shih: A. Hajdini Xani, *Masakra e Tivarit*, f. 35.

²³ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 174.

²⁴ A. Hajdini- Xani, *Masakra e Tivarit...*, f. 35-36.

²⁵ R. Elsie, *Kosovo and the Bar Tragedy of Mach 1945...*, f. 5.

^{**} Në historiografinë shqiptare kemi të dhëna të ndryshme për sa i përket datës së nisjes së Elshonit të dytë dhe të tretë. Kështu, sipas M. Pirrakut, Eshalloni i dytë u nis më 25

arritën në Tivar iu dorëzua reparteve më të mëdha të Brigadës së 10-të malazeze.²⁶ Rreth 700-800 prej tyre gjatë rrugët u vranë ose u zhdukën, prej të cilëve vetëm në Fushë-Arrëz, 126 persona.²⁷

Kolona/grupi i tretë u nis më 27 mars 1945 dhe përbëhej prej 2.700 personave. Për t'i shoqëruar ata u ngarkuan repartet më të mëdha të Brigadës së 27 të.²⁸

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme mund të konstatojmë se vetëm me anë të këtyre tre kolona/grupeve nga Kosova për të plotësuar radhët e Armatës IV të Jugosllavisë u dërguan 7476 luftëtarë të rinj.²⁹ Gjatë rrugëtimit të tyre për në frontet e Adriatikut, të mobilizuarit-rekrutët shqiptarë, u keqtrajtuuan në mënyrë shtazarake nga kriminelët serbo-malazezë dhe ndihmësit e tyre ideologjik.³⁰ Për keqtrajtimin e tyre gjatë rrugës dhe në Tivar, studiuesi Robert Elsie duke u mbështetur në kujtimet e regjistruara nga Zef Pllumi, një shkrimtar katolik i rendit françeskan në një nga episodet e shumta të kujtimeve të tij prej 730 faqesh, ai kujton: *“Në hyrje të Shkodrës...kur një grup studentësh që studiojnë për priftërinë vizitoi Kishën e Zojës së Këshillit të Mirë në rrëzë të kalasë për t'u lutur për shpëtim ...në kthesë në rrugë, pamë një rrugë të pafundme ushtarësh që vinin tek ne. [...]. Ata përparuan ngadalë, duke u ngritur me vështirësi të mëdha në rreshtat e katër. Ishim të tmerruar. Çfarë mund të jetë kjo ushtri? Ata mezi kishin energji për të qëndruar në këmbët e tyre [...]. "Nga jeni?" "Nga Kosova. Ne kemi marshuar vazhdimisht për një javë dhe nuk kemi pasur asgjë për të ngrënë. Kemi ardhur mbi male [...].”³¹*

Për keqtrajtimin e rekrutëve shqiptarë nga pushteti jugosllav mësojmë edhe nga një raport i Komandës së qarkut të Shkodrës, që e informon Komandën e Përgjithshme të UNÇSH-së se trajtimi që ju bëhej kosovarëve të mobilizuar ishte tejet i rëndë. Me këtë rast ajo kërkonte që për të verifikuar saktësinë e këtyre fakteve dhe për t'u dhënë fund këtyre ngjarjeve duhej të

mars 1945 dhe Eshalloni i tretë, më 26 mars 1945. Urdhëronte që brigada e cila do të caktohet për t'i përcjellë eshallonet shqiptare të “lidhet më zëvendëskomandantin e Divizionit të Armatës së IV-të, majorin Gjuro Çetnik, Komandant i Shtabit të Kolonës së Armatës IV-të për shoqërimin e “njerëzve të mobilizuar-rekrutët nga Prizreni deri në Armatën e IV-të”. Shih në M. Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës...*, f. 33-36.

²⁶ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 174.

²⁷ R. Elsie, *Kosov and the Bar Tragedy...*, f. 5.

²⁸ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 174.

²⁹ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 174; M. Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës...*, f. 33-36; A. Hajdini- Xani, *Masakra e Tivarit...*, f. 23.

³⁰ Zekeria Cana, *Ditari i Robërisë*, Vëllimi i II, Prishtinë: Rozafa, 2000, f. 224-225; Ramiz Lushaj, “Masakra e Tivarit, tri fakte bashkëfajësie brenda shtetit shqiptar”, në *Infopress*, e shtunë, 25 shtator 2010, f. 22.

³¹ R. Elsie, *Kosovo and the Bar Tragedy...*, f. 6-7.

ndërhyej edhe pranë misionit ushtarak jugosllav në Shqipëri.³² Në mënyrë të veçantë, një përshtypje të hidhur midis popullsisë së qytetit të Shkodrës bënë vrasjet e ndërmarra në të dalë të qytetit, në urën e Bunës, përpara se kolonat të drejtoheshin nga Ana e Malit.* Për këtë incident më 3 prill, Komanda e Qarkut të Shkodrës e informon ShP të UNÇSh rreth incidentit të lumi Buna, ku në mesnatën e 1 prillit gjatë kalimit të kolonës në skelën e këtij lumi, për arsye të panjohura e ndoshta aksidentalisht, u mbyt një ushtar jugosllav dhe një prej të mobilizuarve.* Por, nga të dhënat e kohës, nuk ishte incident por veprim i menduar mirë. Kjo sepse u inskenua rënia e ushtarit malazez nga trapi në lum, i cili bërtiti se gjoja atë e hodhën shqiptarët dhe kërkonte të gjuhej kundër tyre me armë se po i vrisnin shqiptarët. Ushtria jugosllave që shoqëronte autokolonën, duke aluduar së mbytja u bë me paramendim, hapi zjarr ndaj rekrutëve shqiptarë që prisnin të kalonin lumin. Shoqëruesit e batalionit II të Brigadës së 27 të Divizionit të 46-të komandoheshin nga Qiro Stikoviç.³³ Gjuajtjet vazhduan deri sa aty kaluan tre oficerë shqiptarë me motoçikletë për në Shkodër. Më pas erdhi një major serb me disa oficerë që i mblodhën shqiptarët e mbijetuar dhe filluan t’u mbajnë fjalim për “bashkim-vëllazërim,” “për UNÇ dhe për Titon, me ç’rast u shprehën “keqardhje” për “incidentin” që ndodhi dhe për viktimat e rena, që sipas studiuesit Lefter Nasi ishin 17 persona dhe të tjerët që u plagosën.³⁴ Por, incidenti i sipërshënuar, nuk ishte i fundit dhe më i rëndi për shqiptarët e rekrutuar. Në qoftë se nuk do të ndodhte ajo çfarë ka ndodhur në Tivar, e që do ta shpjegomë më pas, përgjatë rrugëtimit në drejtim

³² L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 175; Studiuesi i referohet *Arkivit Qendror të Ushtrisë* (AQU), Fondi Shtabi i Përgjithshëm. Radiogram nga Shkodra për Komandën e Përgjithshme të UNÇSH. Tiranë, 4 prill 1945.

* Nga të dhënat e dëshmitarëve të kësaj ngjarjeje thuhet se “*tek Liqeni i Shkodrës hipëm në një trap. Atu ishim tejet ngushtë...Kur ishim në breg të liqenit, një shqiptarë u ngatërrua më një roje serbe, sepse ky donte ta hidhte në ujë. Duke rënë në ujë shqiptari e mori me vete edhe serbin ... ushtarët e tjerë na i kthyen armët dhe i vranë 17 shokët tanë dhe plagosën shumë tjerë. Por, do të ishte edhe më keq sikur që mos të vinte një ushtarë shqiptarë nga Shkodra me një motoçikletë. Ai ndërhyri me automatik dhe gjendja u qetësua...*” Më gjerësisht shih: L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 176.

* Në radiogramin nga komanda e qarkut të Shkodrës dërguar Shtabit të Përgjithshëm më 7 prill nënvizohet se ngjarja, sipas konstatimeve të mëvonshme, ishte provokuar nga ana e jugosllave. Më gjerësisht shih: L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 177.

³³ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës*, f. 177.

³⁴ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, 177, Autori i referohet *Arkivit Qendror të Ushtrisë*, Fondi Shtabi i Përgjithshëm. Radiogram, Tiranë, 3 prill 1945.

të frontit të Adriatikut tek Ura e Tamarës mbetën të vranë 500 persona.³⁵ Pra, gjatë rrugëtimit të rekrutëve shqiptarë të Kosovës drejt Frontit të Adriatikut, nuk arritën as një e treta e tyre, ngase gjatë rrugës u vranë qindra e mijëra shqiptarë.³⁶ Për vrasjen pa gjyq në tokën shqiptare të më tepër se 1000 kosovarëve të pa fuqishëm mësojmë nga të dhënat që gjenden në AMPJ.³⁷ Por gjendja e tyre edhe më e vështirë bëhej me të arritur në Tivar, ku lodhja gjatë rrugës, uria, etja dhe pasiguria e jetës tashmë kishin krijuar një gjendje të rëndë tensioni psikik. Të dhënat e historiografisë pohojnë se me të arritur në Tivar, rekrutët shqiptarë jo vetëm që nuk u armatosën ashtu siç ju ishte thënë, por ndaj tyre u bë masakër me përmasa të mëdha, të cilën e ekzekutuan Brigada e 10-të Malazeze (të Divizionit të 46-të).³⁸

Masakra në Tivar

Masakra e Tivarit ka ndodhur më 1 prill 1945, në Tivar, Breg të Tivarit, në ndërtesën e Monopolit të Duhanit, në oborrin e tij dhe në rrugën afër mureve të oborrit, në mënyrën më barbare dhe më tërbuese, vetëm brenda disa minutave, në një sipërfaqe të ngushtë vendi. Ushtria “çlirimtare” serbo-malazeze masakroi, me armë zjarri e armë të ftohta, mijëra shqiptarë duarthatë, të mobilizuar kinse për nevoja të Armatës Antifashiste të Jugosllavisë. Ja si e përshkruan i mbijetuari Xani, këtë krim: “... në të dy anët e hyrjes së oborrit i prisnin me shufra hekuri ... Vetëm në hyrje të oborrit mbetën të vdekur 100-150 persona, ndërkohë në ndërtesë ishin futur rreth 1000 persona, ndërsa në oborr konsideroheshin që ishin nga 2200 deri në 2500. Përveç tyre, në rrugë të rrethuar nga ushtarët mbetën 1000 deri në 1100, tani më jo të rreshtuar por grumbull, për arsye se likuidimi i tyre të kryhej sa ma lehtë. Në përfundim të këtij plani, ushtarët kapën Ramiz Loshin nga fshati Vraniq i komunës së Suharekës, me pretekstin se ai ishte njëri nga ata që kishte tentuar ta merrte revolen, andaj mbi të u zbraz një “Shanzher” revolesh. Sipas Azem Hajdinit, i riu Ibrahim Koca, nga fshati Polac i Skenderajt, së bashku me disa rekrutë, u

³⁵ Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit (më tej: AIDSSH), *Historia e Armatës së Sigurimit të Shtetit*. Pjesa e dytë (nëntor 1944-1948), Tiranë: 1974, f. 64.

³⁶ AIDSSH, Dosja, 340, Viti, 1941, fl. 14. Materiale mbi politikën shoviniste të klikës titiste kundër minoritetit shqiptar në Jugosllavi në periudhën 1949-1951. Tiranë.

³⁷ AMPJ, D. 191. V. 1949, Notë dërguar legatës jugosllave në Tiranë në përgjigje të Notës N.420458, të datës 12 nëntor 1949, të MPJ të Jugosllavisë mbi denoncimin e njëanshëm nga qeveria jugosllave të Traktatit të Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke me Shqipërinë.

³⁸ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 1997, f. 279-285.

drejtuan tek komanda e shtabit, e cila ishte e vendosur në oborr, për t'ua parashtruar këto kërkesa: Të apelonte që të ndërpritej represioni dhe dhuna ndaj rekrutëve shqiptarë dhe t'u lejonin që t'i ndihmonin rekrutët e tjerë që kishin mbetur tek hyrja e oborrit. Por, ende pa e përfunduar paraqitjen e kërkesave ndaj tij u bë masakër, në mënyrë mizore i kanë prerë hundën, veshët, krahët, ku e kane bërë copë-copë.³⁹ Rekrutët u sulmuan nga ushtarët e Brigadës së 10-të Malazeze (të Divizionit të 46-të). Ata u gjuajtën me breshëri të armëve nga të gjitha anët por dhe nga këshilltarët infermierë dhe pjesëtarët “gati të gjitha institucioneve civile e ushtarake” me një fjalë “të gjithë ata që ishin në atë moment aty dhe kishin armë”.⁴⁰ Brenda një ore, shumë nga rekrutët shqiptarë të cilët ishin në oborre dhe në sheshin e ndërtesës gjetën vdekjen nga breshëritë e automatikëve. Madje, nga tmerri që panë një pjesë e madhe u sëmurën psiqikisht, e shumë të tjerë ranë në gjendje kome. Pas një ore e gjysmë ndërpritet zjarri i armëve, ndërsa atyre që kishin mbetur gjallë iu bë thirrje të ngriheshin, ngase duhet mjekuar të plagosurit. Pra, sërish u tradhtuan ngase kur ata filluan të ngriheshin në këmbë, repartet rihapën zjarr. U bë thirrja e dytë sipas së cilës të plagosurve iu premtua se do të dërgoheshin në spitalet e Tivarit, Dubrovnikut e të Splitit, ndërsa atyre që ishin në ndërtesë iu kërkua t'i ndihmonin t'i hapnin rrugët.

Sipas Azem Hajdinit për të biseduar me ushtarët doli Isuf Halili nga fshati Radishevë-Skenderaj dhe pasi u premtua së vrasjet do të ndërpriteshin dolën nga ndërtesa të gjallët që ishin brenda. Gjatë daljes së tyre u kontrolluan një nga një dhe ju mor çdo gjë e vlefshme. Pamjet në oborr ishin tejet të tmerrshme. Ishte shumë e vështirë të identifikoheshin njerëzit ngase shumë prej tyre iu ishte prerë koka apo iu kishte humbur gjysma e fytyrës. Të tjerët, të mbuluar nga gjaku kërkonin ndihmë, ose luteshin që t'i vrisnin e të përfundonte vuajtja e tyre nga plagët e marra.⁴¹

Hipokrizia e pushtetit komunist-jugosllav vërehej hapur, kur në njërën anë kryenin masakra ndaj shqiptarëve, si kjo e Tivarit, ndërsa në anën tjetër oficerët mbanin fjalime për “*vëllazërim–bashkimin*”. Gjatë pastrimit të vendit në mjetet e transportit u ngarkuan bashkërisht të vrarët dhe të plagosurit. Pas kërkesave këmbëngulëse të atyre që shpëtuan u bë verifikimi i të gjallëve. Ata ishin gjithsej 810 veta, mbi 90% e tyre ishin nga ata që kishin qenë të mbyllur në ndërtesë. Midis të gjallëve ishin edhe disa të tjerë që kishin mbetur midis kufomave ose të plagosurve, të cilët ia arritën që të largohen gjatë natës në

³⁹ A. Hajdini – Xani, *Masakra e Tivarit...*, f. 109-112.

⁴⁰ M. Verli, “Disa konsiderata për ngjarjen kulmore politike-ushtarake në Kosovë në muajt e fundit të Luftës së Dytë Botërore”, në *Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1944-1945)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2016, f. 205-208

⁴¹ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 178; U. Butka, *Masakra e Tivarit...*, f. 171.

drejtime të ndryshme. Në bazë të vlerësimeve të atyre që mbetën gjallë, një pjesë e mirë e të plagosurve mund të shpëtonin, në rast se do t'u jepej ndihma mjekësore. Por dhe vuajtjet e të gjallëve nuk mbaruan këtu, ngase atyre përveç që nuk iu ofrua asnjë ndihmë mjekësore, ata u përballën edhe me vështirësinë për t'u kthyer në shtëpitë e tyre.⁴²

Mobilizimi i Prillit - Më 13 prill SHO i Kosovës, urdhëroi rifillimin e mobilizimit të kontingjenteve të reja, të cilat do të përdroreshin po ashtu për të plotësuar radhët e reparteve të Armatës së IV-të jugosllave. Në të njëjtën kohë Shtabi Operativ i Kosovës ngarkoi komandat vartëse në Mitrovicë, Pejë, Prishtinë, Ferizaj, Prizren (por munguan nga qyteti i Gjakovës* - H.A.) për të

⁴² L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 178.

* “Është karakteristikë se nga Gjakova nuk u nisën shumë rekrutë shqiptarë për në frontin e Adriatikut. Udhëheqësit e kohës, një pjesë e mirë e të cilëve ishin nga Gjakova, gjetën arsytetime të ndryshme për rininë e qytetit me arsyetimin se janë djem të vetëm nëpër familjet e tyre e justifikime tjera. Kjo ndërhyrje ishte një rrugëdalje në momentin e duhur. Nga qyteti i Gjakovës, në Kolonën e dytë marshuan Murteza Shtaloja, Fehmi Vehapi dhe Sheh Naki Kurasana. Që të tre u kthyen të gjallë nga fronti i Adriatikut...”. Për mungesën e gjakovarëve në këtë masakër na dëshmon dhe studiuesi Cana “...Sado shkurt të qëndrosh në Kukës, do të piqesh dosido me ndonjë njëri të moshuar dhe gjatë bisedës do të dalësh doemos të masakra e Tivarit më 1945. Nga goja e Rasim Junikut, i cili atëherë punonte në postën e Prizrenit bashkë me Anton Çetën, mësova edhe një fakt që hedhë dritë mbi plojën më të madhe të shovinistëve serbo-malazez, sikur që nxjerrë në shesh edhe një të vërtetë tjetër shumë të hidhur. Ishte ditë e shtunë. Komanda ushtarake serbo-malazeze në Prizren kishte lëshuar urdhëron e shtetrrëthimit, kështu që askush nuk guxonte të dilte nga shtëpia. Filloi gjahu ne njerëz. Ushtria hyri bastisjeve të shtëpive me radhë, nxori të gjithë të rinjtë dhe i shpuri në fushën e kazermave të rrethuara me tela me gjemba, ku bëhej grumbullimi i ushtarëve të “mobilizuar” nga të gjithë skajet e Kosovës. Të nesërme (e diel) Xhavit Nimani së bashku me Predrag Ajtiqin, ktheheshin në Prizren nga Tirana dhe i nxori gjakovarët e tij nga kazerma. Ndër ta ishte edhe Rasim Juniku. Gjithë të tjerët u vunë përpara në marshimin e gjatë të vdekjes. Varret e tyre të padukshme gjenden kudo përgjatë rrugës, nga dalja e Kukësit, Domgjoni i Mirditës, Dushaj, Gomsiqja e deri në Shkodër. Çdo historian të zellshëm do ta preokupojë interesimi profesional dhe njerzor që rudhet në pyetjen: Ç'bëri Xhavit Nimani dhe udhëheqësit e tjerë shqiptarë për t'i shpëtuar njerzit e moshës më të mirë që nuk ishin nga qyteti i Gjakovës? Përgjigja pritet nga ata – sa janë gjallë”. Më gjerësisht shih: Z. Cana, *Ditari i Robërisë...*, Vëll. I, f. 154-155. Po ashtu studiuesi Cana, sjell detaje tejet interesante për këtë ngjarje “Nuk del e besueshme që Fadil Hoxha dhe udhëheqësit e tjerë shqiptarë të mos kenë ditur për masakrën e Tivarit”, studiuesi Cana sjell detaje edhe për diskutimin në mes të Fadil Hoxhës me Enver Hoxhën *Udhëtimi i Fadil Hoxhës, bashkë me Zekeria Rexhën në Tiranë (shtator 1945) dhe biseda me Enver Hoxhën, theksohet denoncimi i Koçi Xoxës por anashkalohet emri i shefit të OZNË-s,*

siguruar kontingjentet përkatëse, ndërsa për shoqërimin e të mobilizuarve deri në vendin e dorëzimit ngarkoi forcat e divizionit të 46-të jugosllav.⁴³ Grupi i Parë u nis nga Prizreni për në Tivar më 19 prill, në përbërje të 1520 luftëtarëve. Grupi i Dytë me 2626 luftëtarë u nis më 20 prill, nën mbikëqyrjen e forcave të Brigadës së 25-të dhe të kompanisë së zbulimit të Divizionit 46-të të Jugosllavisë, ndërsa më 24 prill u nis grupi i Tretë me 1216 persona, i shoqëruar nga forcat e Brigadës 26-të. Pra, në total gjatë muajit prill në veri të Jugosllavisë u dërguan 5362 veta. Rreth 188 burra u zhdukën në rrugë dhe pjesa e mbetur e këtyre forcave u dërgua në Trieste.⁴⁴ Kështu, nga burimet e kohës del se gjatë muajve mars dhe prill të vitit 1945, për plotësimin e Armatës 4-të Jugosllave u dërguan rreth 13.000 rekrutë shqiptarë nga Kosova, të cilët u detyruan me forcë për të shkuar të paarmatosur në Frontin e Adriatikut në Jugosllavi.⁴⁵ Gjatë muajit prill u dërguan edhe rreth 5000* luftëtarë të tjerë nëpërmjet Brigadës së 7-të, që përbëhej nga partizanët shqiptarë të Dibrës, Tetovës, Gostivarit etj.⁴⁶

Sipas studiuesit Shatri, në total nga viset shqiptare në fillim të vitit 1945 u dërguan 14.990 shqiptarë në Frontin e Sremit në përbërje të Brigadave VI, VII dhe VIII kosovare dhe 5000 nga Brigada VII (IV) me shqiptarët nga Maqedonia. Gjatë marsit dhe prillit në drejtim të frontit të Adriatikut nga Kosova u dërguan 12838 rekrutë dhe ndërsa me shqiptarë nga Maqedonia u dërguan 4594 vetë. Në total nga hapësira shqiptare morën pjesë 37 424 për plotësimin e reparteve jugosllave.⁴⁷

Natyrisht që të mobilizuarit nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare kishin një efektiv të konsiderueshëm dhe me ta mund të formoheshin njësitë nga më të mëdhatë të UNÇJ, por këto kontingjente u shpërndanë dhe u përdorën për të plotësuar radhët e reparteve të ndryshme jugosllave. Por, nga radhët e UNÇJ shqiptarët shiheshin si të “dyshimtë” dhe “reaksonarë”. Kjo përcaktoi padyshim qëndrimin armiqësor që u mbajt ndaj tyre. Në reparte të ndryshme shumë nga ata, që po marshonin drejt veriut të Jugosllavisë, në vend që të trajtoheshin si bashkëluftëtarë, trajtoheshin si të burgosur.⁴⁸

Spasoje Gjakoviq. Edhe për këtë intervistë Fadil Hoxha vazhdon të jetë dishepull i Titos. Më gjerësisht shih: Z. Cana, Ditari i Robërisë, Vëll. II, 136-137.

⁴³ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 174.

⁴⁴ R. Elsie, *Kosovo and the Bar Tragedy...*, f. 10.

⁴⁵ M. Shatri, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore...*, f. 287.

* Sipas Azem Hajdnit, Elshalon i posaçëm kishte 5 594 luftëtar shqiptarë, nga Maqedonia.

⁴⁶ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 174.

⁴⁷ M. Shatri, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore...*, f. 287.

⁴⁸ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 174-175.

Përveç Masakrës së Tivarit, pushteti komunist-jugosllav kreu edhe një masakër tjetër ndaj shqiptarëve, të brigadës që përbëhej nga shqiptarët e Maqedonisë. Një nga format për largimin e popullsisë shqiptare nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare ishte dhe mobilizimi i tyre në “Brigadat e punës” të cilat do të marrin pjesë “në ndërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta”. Në fakt brigada të tilla u krijuan në të gjithë Jugosllavinë, por brigadat e tjera anë e kënd saj punonin në ndërtimin e vendit të tyre, ndërsa brigadat shqiptare u shpërndanë nëpër Jugosllavi. Sipas studiuesit Lefter Nasit, “...ata punonin në sektorët më të rëndë, në kushte shumë të vështira të jetës e të trajtimit, në kujtesën e dëshmitarëve ka mbetur e freskët trajtimi që ju bë brigadës punuese...” Brigada përbëhej nga qytetarët shqiptarë të rajonit të Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Kumanovës etj. Brigada kishte rreth 4000 persona dhe duke pritur mjetet e transportit për në Goricë e Trieste ajo ndaloi në Mal të Zi. Pa pritur ndërtesa ku u strehua ajo mori zjarr. Rreth 90 persona nuk patën mundësi të dilnin dhe vdiqën.

Në Goricë brigada ishte e detyruar të kryente punët me të rënda dhe nën mbikëqyrjen e reparteve të OZN-as. Studiuesi Lefter Nasi, ndër të tjera shkruan: “Aty u ndalën me shumë se gjysma të zgjedhur një për një sipas dëshmitarëve i futen në kazerma të veçanta. Mëngjesin e ditës së nesërme shumica e tyre u gjenden të vdekur ndërsa ata që kishin mbetur të gjallë nuk ishin në gjendje të flisnin dhe se sytë ju rrjedhin lotë. Në dhomat e gazit u masakruan gati 2000 veta”⁴⁹

Edhe këtë masakër që pushteti komunist-jugosllav e bëri ndaj ushtarëve shqiptarë të pafajshëm në Goricë e përmend në diskutimet e tij, Rankoviqi: “Rasti i dytë gjithashtu është pasojë e burokratizmit dhe e krimeve të pajustificueshme është që disa shqiptarë nga ai kontingjent u vendosën në lokalet ku më parë ishte një magazinë-baroti, edhe aty u ngulfatën 130 njerëz...Shqiptarët kanë humbur besimin, kjo është e qartë, dhe nuk e kanë humbur për shkak së e kanë ndje në lëkurën e tyre Jugosllavinë e vjetër, por e kanë humbur për shkak të gabimeve të cilat i kryen udhëheqësit tanë ndaj tyre...”.⁵⁰ Shqiptarët për t’i shpëtuar dhunës e terrorit jugosllav arratiseshin nga Kosova, duke kërkuar strehim në Shqipëri. Por ata ndiqeshin edhe në Shqipëri nga njerëzit e UDB-së, dhe pastaj shoqëroheshin për në Jugosllavi, ku gjatë rrugës me pretekste të ndryshme i vrisnin.⁵¹ Në fillim të vitit 1945 autoritetet

⁴⁹ L. Nasi, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës...*, f. 179.

⁵⁰ Fehmi Rexhepi, “Masakra e Tivarit në historiografinë shqiptare”, në *Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1944-1945)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2016, f. 205-208.

⁵¹ AMPJ, F. 151, D. 247, V. 1950, fl. 1. Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit (Dega e I-rë). Relacion mbi terrorin dhe persekutimet në Kosovë, Tiranë, 19 tetor 1950.

jugosllave, pushkatuan ilegalisht dhe pa gjyq edhe në territorin e Shqipërisë, më tepër se 1000 shqiptarë nga Kosova.⁵² Krimet e terrori i ushtruar në Shqipëri në periudhën e pasluftës, dëshkohet nga deklaratat e bëra nga Enver Hoxha, më 31 gusht 1966, ku flet për vrasjen e 1200 shqiptarëve në Tivar.⁵³ Po ashtu për këto krime flasin dhe ish nëpunës të lartë të shtetit shqiptar, si Nesti Kerenxhi, ish zëvendësministër i Ministrisë së Brendshme⁵⁴, Shefqet Peçi⁵⁵ etj.

Për masakrat në Tivar dhe në Goricë të dhënat e para jo të kompletuara zyrtare i hasim nga Aleksandër Rankoviqi, që ishte udhëheqës i lartë në nivel të Serbisë e Jugosllavisë, i cili i paraqiti të dhënat për këtë ngjarje në Kongresin Themelor të Partisë Komuniste të Serbisë, që u mbajt në Beograd më 8-12 maj 1945.⁵⁶ Në këtë kongres gjatë diskutimeve nga të pranishmit u pranua si një gabim i tmerrshëm, ngase sipas tyre u vranë 430 persona, mirëpo kjo shifër u minimizua skajshmërisht. Përveç kësaj, Aleksandër Rankoviqi mendohej që gjithë fajin t'ua ngarkojë udhëheqësve të Kosovës. Gjatë diskutimeve me Dushan Mugoshën ndër të tjera ai thoshte: “...Unë nuk do të futem në detaje. Një shqiptar i revoltuar në një përcjellës, hoqi pushkën dhe e vrau. E vrau një shokun tonë luftëtar. Por shokët tanë që në vend se tërë ngjarjen ta zgjidhnin, që të mos nxiteshin grindje, ata kanë dashtë t'i dënojnë, kanë dashtë të zbatojnë reprezalje, deshën të pushkatojnë 40 shqiptarë për një luftëtar tonin të vranë. Disa shqiptar filluan të hidhnin bomba. U hodhën disa bomba. Ndërsa, udhëheqësit tanë hapën zjarre dhe vranë 300 shqiptarë. Ky është një shembull që patjetër duhet të mësojmë edhe ne që punojmë me ushtri dhe që punojmë në teren...”. Në vazhdim të diskutimeve Rankoviqi përmendi edhe rastin e

⁵² AMPJ, F. 151, D. 191 (B/ V-2), V.1949, fl. 43. Relacion rreth terrorit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë e Shqipëri.

⁵³ Fatos Beja, *Krime Luftë në Tivar* – Raport për Komisionin Parlamentar, Tiranë: Botimet Klean, 2013, 91.

⁵⁴ Më 28 mars 1948 ka deklaruar: “Në Drejtorinë e Sigurimit kanë ardhur disa lista kosovarësh, të ikur nga Kosova dhe dezertorë, që kërkoheshin për t'u arrestuar. Nuk më kujtohet kush i sollti ose si erdhën këto lista, vetëm di se u është dhënë urdhër Organeve të Sigurimit që, po të kapen, t'i përcjellin në Jugosllavi. Dhe kjo punë është bërë”. Shih në Ndreçi Plasari & Luan Maltezi, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave 1945-1948*, Përmbledhje dokumentesh, Tiranë: Gjergj Fishta, 1996, f. 578.

⁵⁵ Në kohën e pluralizmit politik, do të rrëfente mbi ekstradimin e shqiptarëve nga Kosova në drejtim të Tivarit: “isha në Shkodër, kur po kalonin ata kosovarë të gjorë për në Mal të Zi, me mijëra e mijëra, të lodhur, të uritur, të keqtrajtuar..., kisha dëgjuar se kosovarët i kishin marrë me forcë për t'i çuar në Tivar. Për më tepër shih: Apostol Duka, *Udhëkryqe të Historisë* (rrëfyer nga miqtë dhe armiqtë e Enver Hoxhës), Tiranë: Toena, 2007, f. 116-117.

⁵⁶ *Osnivački Kongres KP Srbije*, Institut za Istoriju Raničkog Pokreta Srbije, Beograd: 1972, f. 157-158; F. Rexhepi, *Masakra e Tivarit në historiografinë shqiptare...*, f. 205-207.

masakrimin të ushtarëve shqiptarë në Goricë “*Rasti i dytë që ...disa shqiptarë nga ai kontingjent u vendosën në lokalet ku më parë ishin magazinë-baroti dhe aty u ngulfatën 130 njerëz...*”.⁵⁷

Por, pa marrë parasysh qëndrimin e udhëheqjes jugosllave, e cila në këtë kongres shprehte “pendimin” rreth tragjedisë së Tivarit dhe të Goricës, duke u munduar që gjithë fajin t’ua hidhte shqiptarëve, kjo çështje mbeti e mjegullt deri në vitet ’90-të të shekullit të kaluar.⁵⁸

Arsyeja për këtë ishte e qartë ngase në vitet në vijim komunistët jugosllavë nën Titon nuk ishin të interesuar për zbardhjen e krimeve të kryera kundër rekrutëve shqiptarë.

Por, ndonëse është shkruar në historiografinë shqiptare për këto masakra, pas viteve 90-të, ende janë mbetur disa segmente ta pa trajtuara si shembull numri i të vrarëve, i cili varion me shifra të ndryshme, në shumë studime. Kështu, sa i përket numrit të të vrarëve në frontin e Adriatikut mund të themi se ishte tejet i madh. Vetëm gjatë marshimit të rekrutëve shqiptarë në territorin shqiptar gjetën vdekjen nga 400 deri në 1000 shqiptarë. Sipas Komandantit të Brigadës së 7-të Kosovare, Shaban Haxhia në Tivar u vranë 1600 rekrutë shqiptarë.⁵⁹ Por, duke u mbështetur në të dhënat e historianit Uran Butka, i cili ka analizuar shifrat e dhëna nga burime të ndryshme mësojmë që gjithsej 2.2947-3.447 shqiptarë të vrarë, të mbytur e të helmuar e të zhdukur në frontet e Adriatikut.⁶⁰ Ndërsa, sipas të mbijetuarit të Masakrës së Tivarit, Azem Hajdinit, në Tivar u masakruan 4.310 shqiptarë si dhe u bë helmimi i më se 1.340 luftëtarëve të tjerë në kazerma ushtarake në Dubrovnik.⁶¹ Ndërsa, sipas studiuesit Robert Elsie, që të dhënat i mbështet nga statistikat ushtarake, mësojmë që 2,543 rekrutë shqiptarë u vranë, por sipas tij, kjo shifër mund të jetë shumë më e lartë, ngase sllavët natyrisht që kishin prirje për ta zvogëluar shifrën e të vrarëve.⁶² Shifër të përafërt të të vrarëve na ofron studiuesi Muhamet Pirraku, sipas të cilit vetëm në Masakrën e Tivarit janë vrarë 1700 shqiptarë, ndërsa po të shtohet edhe numri i të vrarëve në Dubrovnik dhe i atyre gjatë rrugës nga Prizreni deri në këtë qytet shifra arrin diku 2.400 qytetarë shqiptarë që u vranë në frontin e Adriatikut.⁶³ Të dhëna për numrin e viktimave na ofron dhe Fatos Beja, ku sipas tij numri i të vrarëve është më i madh se 600

⁵⁷ F. Rexhepi, *Masakra e Tivarit në historiografinë shqiptare...*, f. 205-208.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ *AMPJ*, V.1949, D. 202. f.31. Deklarata e Komandantit të Brigadës së 7 të Kosmetit Shaban Haxhi Demolia.

⁶⁰ U. Butka, *Masakra e Tivarit...*, 265-270.

⁶¹ A. Hajdini-Xani, *Tragjedia e Tivarit...*, f. 25.

⁶² R. Elsie, *Kosovo and the Bar Tragedy...*, f. 10.

⁶³ Muhamet Pirraku, “Në Tivar u masakruan 1700 shqiptarë”, *Zëri*, nr.1434, Prishtinë, 11 janar 1992, f. 42-43.

dhe më i vogël se 1560 persona. Për të dalë te numri i saktë i viktimave në Tivar janë të domosdoshme lista e të nisurve nga Prizreni, lista ku ju janë dorëzuar Brigadës së 10 Malazeze më 30 mars në Shkodër, si dhe lista prej 800 vetash që u regjistruan në hyrje të ndërtesës së Metropolit të duhanit.⁶⁴ Pra, as një studim për këto ngjarje nuk mund të konsiderohet i plotë pa shfrytëzuar dokumentet e plota në arkivat jugosllave.

Si përfundim, mund të themi se shqiptarëve në Frontin e Adriatikut dhe në veçanti në Masakrat e Tivarit e Goricës i kushtuan me mijëra të vranë e të plagosur dhe shumë nga të mbijetuarit më trauma psikike. Por, këto ngjarje dhe masakra nuk ishin rasti i vetëm kur shqiptarët u vranë dhe u masakruan.⁶⁵

Përfundimi

Nga 1 prilli 1945 kur ndodhi e deri në fillim të viteve 90-të kur ra sistemi komunist, ngjarja ndër më tragjike në historinë e popullit shqiptar, që njihet si Masakra e Tivarit nuk është trajtuar si duhet dhe sa duhet, për shkak të ndikimit të ideologjisë komuniste. Trajtimi i drejtë i ngjarës së Tivarit, kërcënonte me destabilizim të marrëdhënieve etnike dhe të ashpra midis shqiptarëve të Kosovës dhe malazezëve, që jetonin në kontakt të ngushtë me njëri-tjetrin në Jugosllavinë jugore. Madje, jo vetëm që nuk u shkrua deri në këtë periudhë, por ata që inskenuan këtë tragjedi, sikur deshën të humbnin çdo gjurmë të kësaj masakre. Edhe nga dëshmitarët e kohës, që fati i shpëtoi nga vdekja dhe shtresa intelektuale e akademike deri në fillim të viteve 90-ta të shek. XX, sikur e heshtën këtë ngjarje të trishtë për popullin shqiptarë, në veçanti atë të Kosovës.

Kjo heshtje, si nga ana e botës akademike po ashtu edhe nga dëshmitarët e kohës, mbase ishte e kuptueshme, po të kemi parasysh rrethanat në të cilat ndodhej populli shqiptar i Kosovës pas vitit 1945, periudhë në të cilën nuk ishte e favorshme të diskutohej e të shtrohej kjo çështje. Mirëpo, pas rënies së komunizmit (1990), Masakra e Tivarit, filloi të zbardhej nëpërmjet studimeve nga autorë të ndryshëm andej e këtej kufirit.

Por, si erdhi deri tek kjo masakër? Atëherë, në fund të Luftës së Dytë Botërore, konkretisht në muajin mars 1945, forcat jugosllave me pretekstin e mobilizimit të rinisë shqiptare për t'i angazhuar në vatrat e fundit të frontit, mblodhën një numër të madh të rinjsh kosovarë, për t'i çuar në Tivar, ku do të visheshin e do të shkonin në front. Mirëpo, fatkeqësisht, nga pushteti i Beogradit këta rekrutë shqiptarë, u tradhtuan dhe pjesa dërmuese prej tyre u

⁶⁴ F. Beja, *Krime Luftë në Tivar...*, 96.

⁶⁵ M. Verli, *Disa konsiderata për ngjarjen kulmore politike-ushtarake në Kosovë...*, f. 205-208.

masakruan rrugës, ndërsa pjesa më e madhe në Tivar (shifrat variojnë nga 1700-4310).

Së fundmi, mund të themi se masakra e mijëra shqiptarëve te pafajshëm në Tivar (apo Frontin e Adriatikut), mund të jetë një ndër krimet më të mëdha të Luftës së Dytë Botërore jo vetëm në Ballkan, por edhe në Evropë, ndërsa për shqiptarët kjo masakër mund të klasifikohet si një ndër katastrofat më të mëdha kombëtare. Ndërkaq, Tivari si vendi ku u krye krimi, nuk u zgjodh rastësisht, por për shkak se ishte larg nga të gjitha lidhjet komunikuese, që ua mundësonte kryerjen e krimit në mënyrë tejet të fshehur. Pastaj, shkëmbinjtë, kanionet dhe deti i gjerë, ofronin mundësi ideale që t'i ekzekutonin pa gjurmë të gjitha viktimat dhe kufomat e plojës, në mënyrë që tërë ato krime t'i mbulojë heshtja, duke mos dhënë asnjë të dhënë për opinionin, në veçanti atë ndërkombëtar.

Së fundi, mund të themi, kanë kaluar mbi 74 vite nga Masakra e Tivarit, por ende ka mbetur e errët, thuajse e panjohur gjatë gjithë periudhës së sistemit komunist të Enver Hoxhës, e zvogëluar dhe e justifikuar nga serbo-malazezët. Andaj, kjo masakër ka mbetur e pa hetuar, e pa studiuar, pa përgjegjës e përgjegjësi. Por, pas përfundimit të këtij punimi studimor, mund të themi të bindur se masakra që iu bë rekrutëve shqiptarë nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Maqedoni në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore në Tivar (apo në frontin e Adriatikut), ishte ndër ngjarja më tragjike për shqiptarët, të cilët së pari u tradhtuan dhe më pas u mbytë, u masakruan nga pushteti komunisto-jugosllav.